

ALBANIAN POST

Nr.
78

SHKURT /
FEBRUARY
2025

Editor in Chief: Dr. Fatmir Terziu - Telephone: 07984497444 - contact@fjalaelire.com - www.fjalaelire.com

Rest In Peace

Luljeta Nuzi



21 Memorje...




12-13 Studim...

KOLA CONSTRUCTION

AWARDS BEST TREND 2023



16-17 Kola...



19 Demokracia...

ME SHPIRTIN E TË PARËVE

Ae dini historinë e ...? Me shpirtin kolektiv të të parëve. Me vorbullën e paraekzistencës. Aty ku nuk jam dhe jam aty. Thjesht si një ide vazhdimi në kohë, pa një pikë shpjegimi racional se ku do të shkoj në jetën time dhe pse i kam gjithë këto pasione të trashëguara, zjarre të egra djegëse në kockat e paraardhësve të mi të ikur. Ishte një ritual. Me një dëgjim patriarkal të përrallës së njohur, të dashur dhe të bërë me respekt, një pyetje e vetme, pikërisht në një moment të caktuar, shumë e rëndësishme, për të shpalosur magjinë. Gjyshja ime, ma tregonte sa (vijon në faqen 02)

herë që fillonte të punonte me grep për të gjithë familjen. Shikova gishtat e saj, rizoma të gërvishtura e të shkathëta, të mbërthyer në leshin e gjelbër si një kallam në bar dhe u përgatita të kërceja në kujtimet e saj. I lumtur shpërtheva guaskën e vetes, duke shijuar marramendjen fillestare të zhytjes në memorje. Dhe ... A e dini historinë e ...? Unë isha vetëm dhjetë vjeçar. E gjyshja më tregonte përrallë. Përrallë? “Djali nuk duhet të jetë i përfjetur! Sytë duhet ti ketë katër...”- shtonte ajo. Gjyshi zdrugonte dhe sytë ia kalonte hera-herës gjyshes, së cilës i shkëlqente një...

FLORA'S GUSTO ITALIAN



- Wedding 🍷
- Family Events 🍷
- Office Event 🍷
- Birthday Event 🍷

BOOK NOW

call for booking 0208904775 📞



SUPERMARKETI I SHQIPTARËVE

HILAL FOOD CENTRE

Supermarketi i shqiptarëve në Kilburn High Road. Aty ku nën drejtimin e biznesmenit Mahmut Siringul do të gjeni të gjithë produktet e cilësisë lartë dhe me çmime konkurruese.



KUALITET- CILËSI



02073721059

info@hilalfood.co.uk



22-324 Kilburn High Road, NW6 2QN

MIRË SE VINI!

WWW.FJALAEIURE.COM

(vijon nga faqja 01) ... dhëmb floriri sa herë ia kthente shikimin mbrapsht. Dhe pastaj kthehej prapë nga unë, nga unë kureshtari i rrëfimeve ...

“Kur ajo ia nisi këngës, ajo dogji beqarin më të pavendosur! Kështu qëndruan dorë për dorë, deri në fund të ditëve, përtej maleve, mbi fshat e zall, përtej vapës dhe të ftohtit, derisa u strehuan nën zemrën e mëshirshme të Zotit! Dhe ai fshihej pas gardhit, eh na e hoqën bukurinë, sojin, të

shkretën dhe plogështinë, që nuk na la të kalonim pragun, të mos ndihemi fare grua!” - përfundonte gjyshja. Përralla me shumë nëkuptime rrëfehej para syve të mi të magjepsur, terliku i gjelbër i sapo endur, i rrezuar dhe i përsosur si një dardhë e egër e papjekur, e shtrembër, plot shëndet dhe kokëfortësi më zhyste në mendime. Nuk guxoja ta prek, i emocionuar për linjën time të afërt të kultit, pyetja nga e cila varet gjithçka. Dhe vazhdimi i

jetës mbrapsht, në mitologjinë e së shkuarës personale të gjyshes sime, një peng për paraqitjen time në botë. Dhe dëshira ime e furishme për të lënë trashëgim më shumë shpirt dhe gjallëri si e imja.

“Gjyshe, pse vazhdoni të më tregoni përralla të tilla?”

“Eh, pse? Po kujt t’ia rrëfej ato që i dëgjoja nga gjyshja ime?”

“Ajo thoshte: Kushdo që e merr (e kishte fjalën për mua) do të flasë me Zotin!” Dhe ia shkelte syrin gjyshit tim. Ai përhumbej

e përhumbej aty në zdrugim... E ku kuptoja atëherë këto gjëra. As Zotin nuk e mësonim në shkollë. Nuk flisnim as në orë të Historisë. E unë isha atëherë vetëm dhjetë vjeç. E si një dhjetëvjeçar fjalët tani më sjellin vërdallë. I kujtoj, kam mall, kam shumë e shumë fjalë që dua ti rigrumbulloj si atëherë me ngadalë, me ngadalë ... A e dini historinë e ...? Dhe tani unë duhet ta ritregoj në një formë tjetër atë përrallë.

A JENI NË DIJENI TË LEGJISLACIONIT TË RI PËR MBETJET USHQIMORE?

Ligji i ri i mbetjeve ushqimore duhet të hyjë në fuqi më 31 mars 2025. Ai do të ndikojë tek organizatat publike dhe të sektorit të tretë si shkollat dhe spitalet, si dhe prodhuesit e ushqimeve, shitësit e ushqimeve dhe mikpritjet, me bizneset që prodhojnë më shumë se 5 kg mbetje ushqimore çdo javë që pritet të organizojnë grumbullime të veçanta. Kjo do të përfshijë çdo mbetje të materialit të biodegradueshëm të prodhuar gjatë përpunimit ose përgatitjes së ushqimit, të tilla si kockat, lëvozhgat e vezëve, lëkurat e frutave dhe perimeve, qeskat e çajit dhe llumrat e kafesë. Ato biznese me më pak se 10 punonjës me kohë të plotë do të kenë një periudhë mospagimi, duke u futur në objektin e ligjit nga fundi i marsit 2027.

Megjithatë, parandalimi i mbeturinave ushqimore, duhet të jetë gjithmonë prioriteti, me bizneset

që trajtojnë shkaqet në rrënjë dhe përfshijnë reduktimin e mbetjeve ushqimore në planet e tyre të vazhdueshme mjedisore.

Kjo mund të përfshijë shitësit që vlerësojnë stokun dhe reduktojnë produktet që nuk funksionojnë mirë, ose ofrojnë “shitje të shpejta” për artikujt me data të shkurtra, ndërsa

operatorët e shërbimeve ushqimore mund të shikojnë menutë e reduktuara, duke përmirësuar ruajtjen e ushqimit për të zgjatur freskinë e produkteve dhe më shumë.

Hulumtimi ka treguar se parandalimi i mbetjeve ushqimore që lindin në radhë të parë kursen rreth nëntë herë më shumë emetime

sesa dërgimi i tyre në tretje anaerobe, shton eksperti “Ne i bëjmë thirrje qeverisë të zbatojë raportimin e detyrueshëm të mbetjeve ushqimore për bizneset e mëdha dhe të mesme si prioritet, si dhe politika për të parandaluar mbetjet ushqimore, si mbrojtja nga praktikatat e padrejta tregtare që çojnë në mbetje ushqimore.”



FLORA'S




Gusto Italian



Flora's Gusto Italian



!
VLERËSUAR
PËR
HIGJENË



Restoranti i munguar modern i shqiptarëve

02089047775

DY MINUTA NGA UNDERGROUNDI PRESTON ROAD


“FLORA’S GUSTO ITALIAN” VLERA DHE RESPEKTI

Doni të ndjeni vetveten? Doni të kuptoni ku mbetet cilësia? “Flora’s Gusto Italian” vlera dhe respekti ju mbetn argumenti.

Kështu lehtësoni stresin e kohës dhe panikun e jetëditësisë, duke i lënë profesionistët të bëjnë të gjithë punën. Një restorant i preferuar në Londër po mban hapur dyert e tij në ditën e duhur për ushqim, si dhe për pijet tradicionale të pasdites ose gotën e trokitjes. Mbetet i hapur ky restorant, duke u ofruar mysafirëve një pritje të ngrohtë në ditën e madhe për mysafirët dhe ata që qëndrojnë diku tjetër. Pra, nëse

dëshironi një festë të plotë tradicionale, një alternativë interesante vegjetariene, apo diçka krejtësisht të ndryshme, ne kemi zgjedhur fjalët më të ëmbla që mund të thuhet për ju në Londër, duke e vizituar dhe frekuentuar pikërisht këtë restorant. Kjo është ajo, që edhe gjithkush do të dëshironte.

Sa hyn tek restoranti “Flora’s Gusto Italian” në Preston Road, ose më saktë vetëm dy minuta nga Undergroundi, syri sheh formën më esetike të ambientit, pastërtinë dhe mesazhin që të jep profesionalizmi i stafit dhe tërësisë që plotëson këtë



ambient sa të bukur, tërheqës aq dhe të kompletuar. Kështu festat e fundvitit, natyrshëm janë nga më të dëshiruara të shijohen në ambientin që reflekton kulturë dhe lloj-llojshmëri tradicionale dhe moderne të kuzhinës shqiptare, italiane dhe asaj më të përparuar që ekziston sot.

“Flora’s Gusto Italian” në Preston Road natyrshëm është një ide, investim dhe përkushtim i biznesmenes, ideatores dhe profesionalistes, Flora Kolaveri Osmani, që vazhdon ta udhëheq me përkushtim dhe profesionalizëm. Në prag të këtyre festave të fundvitit ajo ka shtuar gamën e ushqimeve tradicionale dhe të porositura, duke e bërë këtë restorant nga më të kërkuarit, vlerësuarit dhe të përshtashmit për të kaluar një kohë festive të bukur e të relaksuar.

Mbi të gjitha “Flora’s Gusto Italian” në Preston Road, shkëlqen nga pastërtia dhe

reklamon sigurinë më të madhe që ndodh të jetë nëpër restorante. Familjarë, individë, organizma dhe shoqata, por dhe grupe të ndryshme mund të kontaktojnë dhe të prenotojnë vendin e tyre në një drekë, darkë apo dhe në mundësi tjetër për të shijuar vërtet atë që afron vetëm “Flora’s Gusto Italian” në Preston Road.

Kur “Flora’s Gusto Italian” u hap me idenë dhe angazhimin e Flora Kolaveri Osmanit, ai u bë shpejt restorant më i frekuentuar, më i zgjuar në këtë cep të kryeqytetit shpesh të ngarkuar me kalimtarë të thjeshtë e me turistë. Kur bëhet fjalë për gostitë festive, restoranti kryesor do të përfshijë një menu me pjata më pak tradicionale dhe pjata më klasike të konkurrencës ku natyrisht do të gjeni dhe raki. Të gjitha të shoqëruara me një gotë Veuve Clicquot Brut, natyrisht, nga ajo që shijohet me estetikën dhe shijen e këtij restorant të bukur dhe estetik.

Mendo për ëndrrën tënde,
mos u ndall!

Ne jemi këtu për Ju.
www.fjalaclire.com

Reklamo tek revista
"Albanian Post"



Duete

Food Centre

Supermarketi jonë është një vend i përsosur për të gjetur ushqimin tuaj të preferuar shqiptar! Ne përdorim vetëm burimet konkurruese për të siguruar cilësinë e shportës sonë.



Oferta speciale dhe çmime konkurruese



MERRENI PRODUKTIN SHQIPTAR ORIGINAL!



151-155 BALLARDS LN, CHURCH
END, LONDON N3 1LJ

ENCIKLOPEDIA “SHQIPTARËT NË ARTIN BOTËROR” NDËR MË TË KËRKUARAT NË BRITISH LIBRARY

Në Bibliotekën Britanike (British Library), ose sikurse quhet edhe Biblioteka Kombëtare e Mbretërisë së Bashkuar, ku raftet-arkivore mbajnë mbi 170 milionë artikuj, pra një koleksion i gjallë që bëhet më i madh çdo ditë, ndodhet dhe Enciklopedia “Shqiptarët në artin botëror”, enciklopedi e autorit të mirënjohur shqiptar, Prof. Dr. Ferid Hudhri (2012). Në Katalogun online të këtij institucioni, ku rrënjët e tij shtrihen në shekuj, dhe ku mblidhet gjithçka e botuar sot, që të shërbej për nesër dhe për dekada në të ardhmen, ku ka miliona klikime, kërkime për miliona libra, por edhe gazeta, harta, regjistrime zanore, patenta dhe pulla, rezulton se libri në fjalë i Hudhrit mbetet mjaft i kërkuar nga lexuesit. Përpara se Katalogu të sulmohej nga hakerat, rezultonte në disa mijëra klikime, dhe natyrshëm zyrtarët e këtij mjedisi mjaft të vizituar dhe me një emër të madh Global, e deklaroinin këtë me një krenari të veçantë. Arsyet ende nuk dihen, por dihet se kjo Enciklopedi është e vetmja, e munguara ndër vite, dhe me një cilësi të madhe e të padiskutueshme të realizimit të saj.

Ky libër mjaft cilësor i autorit Hudhri, është i kërkuar dhe për shumë arsye të tjera, që vijnë nga vlerat, kërkimi adekuat dhe profesional, trajtimi i sqimtë e mirëfilli shkencor i të gjithë burimeve, gjithëpërfshirja, informacion i një modeli të paparë, materiali ilustrues burimor dhe trajtimi i detajuar e i planifikuar mirë në vetë strukturën e

Enciklopedisë. Duke ditur se për shekuj me radhë, në kufijtë midis kohërave dhe orekseve kohore, territori i Shqipërisë ishte një lakmi e hershme e Perandorisë Romake, pastaj e Bizantit dhe forcave të tjera agresive dhe grabitëse, dhe në periudhën e hershme moderne pre e Perandorisë Osmane dhe më pas edhe nën Pushtimin italian, apriori ishte dhe fakti që mbeti nën mjaft ndikime. Këto ndikime të mbivendosura kanë rezultuar në varietete kulturore në të gjithë Shqipërinë, ku përveç lidhjes gjeografike është vetë një ndikim karakteristik për Ballkanin më të gjerë, madje edhe për Mesdheun. Ndikimi bizantin në Shqipëri ishte i thellë, kryesisht përmes tregtisë dhe ndikimeve romane, ashtu sikurse pasuan më pas ndikimet e kulturës dhe arkitekturës italiane.

Edhe pse me pak gjasa të mbaheshin në këmbë shumë nga këto arritje dhe qasje me ndikime, kishat dhe manastiret e asaj periudhe i japin shumë vlerë dhe dimension. Shqipëria ka pesë monumente kulturore të regjistruara në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s: Butrintin, Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës, Amfiteatrin e Durrësit, Varret Mbretërore të Selcës, si edhe Trashëgimia



Natyrore dhe Kulturore e rajonit të Ohrit. Ka valle tradicionale popullore nën shoqërimin e tradicionales (Vallja e Tropojës) janë të regjistruara në Listat e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të UNESCO-s. Ministria e Kulturës dhe Informacionit ka për detyrë të ruajë trashëgiminë kulturore të vendit dhe të mbikëqyrë zhvillimin e saj. Aktivitete të mëtejshme në mbështetje të zhvillimit të kulturës ndërmerren në nivel të qeverisjes vendore. Por kjo është në një plan të gjerë, në një plan që i përket ministrisë, ndërsa atë që ka bërë autori i Enciklopedisë natyrisht është një punë e munguar, një vlerë e madhe dhe një risi e ndjeshme edhe për të huajt, që kohët e fundit duket se kanë shtuar orekset për ta rizbuluar ndryshe.

Kësisoj në këtë pikë Enciklopedia “Shqiptarët në artin botëror” ka rolin e saj të padiskutueshëm. Pse e themi këtë? Së pari nga vetë fakti që ajo është ndër më të kërkuarat dhe së dyti ngase ajo është e strukturuar dhe e paisur edhe me aparatën e duhur ndihmës, i nevojshëm ky për të lehtësuar konsultimin e shpejtë dhe efikas nga ana e lexuesit dhe studiuesve. Indeksi i jep asaj një kënd tjetër profesional dhe kështu ajo mbetet në kornizat më të larta akademike dhe kërkuese si vlerë. Vetë teksti i enciklopedisë është pajisur me indeksin e personave që paraqiten në veprat e artit, si edhe listën e veprave të artit, ku këtu mirëkuptohet se cili ka qenë “gjahu” rreth të cilit të huajt e artit janë vërtitur... (vijon në faqen 07)

(vijon nga faqja 06)

... e frymëzuar më shumë. Këtë e vërtetojnë qasjet me figurat historike. Figura të tilla si Skënderbeu, Ali Pashë Tepelena, Mehmet Ali Pasha, Ahmet Zogu, Aleksandër Moisiu e deri tek ato bashkëkohore si Ismail Kadare dhe Nënë Tereza, natyrisht janë embrioni i këtij thelbi.

Prof. Dr. Ferid Hudhri nga eksperiencia e tij e gjatë, nga koha me të cilën ai ka hulumtuar, e zbuluar, gjetur e përshtatur, një kohë gati katër dekadash në studim, kërkim dhe hulumtim shkencor, ka ditur të flasë me dy gjuhë të veçanta.


Themi kështu se ka ditur ti afrojë shqiptarëve një realitet të akumuluar dhe të parë në një kënd ndryshe mes artit dhe në anën tjetër mjeshhtërisht ka ngritur diskursin të informojë edhe për jetën dhe karrierën artistike të autorëve, duke theksuar interesimin dhe përkushtimin që ata kanë pasur ndaj botës shqiptare, f e n o m e n e v e shqiptare, koloritit dhe kostumografisë, virtyteve dhe tipareve, natyrës së Shqipërisë, njeriut shqiptar, objekteve dhe kulturës materiale shqiptare. Për secilin prej piktorëve, apo skulptorëve autori ravijëzon edhe punimet me subjekt shqiptar që ai ka realizuar, historiku i krijimit dhe ekspozimit të tyre, lëvizjet nëpër ekspozita dhe koleksione të ndryshme dhe vendndodhja aktuale e tyre.

Enciklopedia “Shqiptarët në artin botëror”, kjo vepër monumentale e Ferid Hudhrit, nuk është thjesht një botim i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit pranë Qendrës së

pesëqind faqe, dhe duke ditur se enciklopeditë janë vepra referimi, ose përmbledhje që ofrojnë përmbledhje të njohurive, të përgjithshme, ose të veçanta, në një fushë, ose disiplinë të caktuar dhe për

Faktet e tjera burojnë nga ajo që përfshihet në këtë vepër voluminoze, por dhe nga konteksti që dihet e përfshihet se trojet e banuara nga shqiptarët, ashtu si dhe fatet e kulturës shqiptare, ndonëse

gjeografikisht i takonin Europës, u mbajtën për shumë kohë larg ndikimit iluminist, ngaqë për shkaqe që tashmë dihen, ndodheshin në skajin më të largët të Perandorisë Osmane e për rrjedhojë, u ndien gati të harruara. Ajo që vlen të citohet është se një ndikim pati Orientalizmi. Orientalizmi tregoi interes për skenat orientale në artet pamore të shekullit të 19-të. Fushata e Napoleonit në Egjipt, pushtimi i Algjerisë, si dhe librat e udhëtimeve dhe përshkrimet e tjera letrare, nxitën entuziazmin dhe imagjinatën e artistëve. Vendet islamike ishin bërë destinacioni i preferuar i udhëtimit për shumë artistë. Skenat e shesheve, pazareve, haremit dhe ngjarjeve të ndryshme folklorike hynë



Studimeve Albanologjike, por një përkujdesje e gjatë dhe e gjallë shpirtërore, profesionale, akademike dhe art-përcjellëse, që konkuron me vlerë, me cilësi, me art dhe me çdo gjë në përgjithësi, thuajse me të gjithë paraqitjet e këtij lloji në kohë të ndryshme. Në këtë pikë duke parë volumin e saj të madh, që natyrshëm është rreth

to angazhohen institucione të tëra, e themi padyshim më të vogël, se kjo Enciklopedi është ajo që e bën Prof. Dr. Ferid Hudhri një institucion më vete. Kjo e mjaft të tjera si kjo e bën këtë Enciklopedi mjaft të kërkueshme edhe në Bibliotekën Kombëtare të Britanisë së Madhe.

në pikturën evropiane. Orientalizmi rrallëherë kishte një karakter thjesht dokumentar dhe më shpesh përshkruante entuziazmin e evropianëve për bukurinë, gjallërinë dhe joshjen e botës së panjohur dhe ekzotike. Natyra e egër dhe zakonet e pazakonta, të kombinuara me ngjyrat... (vijon në faqen 08)

(vijon nga faqja 07)

... dhe dritën e mrekullueshme, ishin bërë një frymëzim i madh për artistët evropianë. Një shembull mbetet vlera e pikturës historike të Leopold Müller-it, e njohur për motivet e saj orientale. Nuk ka dyshim se mësimet vendimtare të Millerit përcaktuan preferencën e mjaft subjekteve për pikturë, që vunë në dukje rritjen e interesit të Evropës për ngjarjet në Ballkan. Kështu krahas tij që udhëtoi në Shqipëri, Mal të Zi, Dalmaci, Bosnjë-Hercegovinë dhe Serbi duke mbledhur skica dhe studime të jetës së popujve ballkanikë, janë dhe të tjerët që mbajnë vendin e tyre në këtë Enciklopedi, që për fatin e mirë pamje të jetës së përditshme prej punës së tyre përjetësoheshin në tablo, statuja, monumente, si dhe në vepra të tjera arti. Gjithë kjo krijimtari e begatë, shtrirë në të gjitha gjinitë dhe zhanret e arteve pamore, përbën objektin diskursiv të enciklopedisë së hartuar nga Ferid Hudhri.

Para disa vitesh, kur në Ambasadën e Shqipërisë në Londër ishte Kryediplomati shqiptar, që në vetvete kishte dhe një shije të lartë estetiko-kulturore, po aq dhe atdhetare-dashmirëse ndaj artit dhe letërsisë, publicisti dhe studiuesi i njohur Mal Berisha, Enciklopedia “Shqiptarët në artin botëror” së bashku me disa libra të tjerë të rëndësishëm u ekspozua në kënde të ndjeshme e të mirëndërtuara për vizitorët e huaj. Ndërsa kjo enciklopedi u pasqyrua krahas librave të Kadaresë, Elsie, e mjaft të tjerë natyrisht kishte dhe meritoren tjetër përkrah saj në gjuhën angleze me titullin “Albania in the World Art”, (Athinë, 1990), e cila ishte e plotësuar me 100 riprodhime të reja në pikturë, skulpturë dhe grafikë.

Të mos harrojmë edhe faktin tjetër se kjo enciklopedi kur iu dhurua nga ish-Zëvendëskryemintsi i Shqipërisë dhe Ministër i Arsimit, Kulturës dhe Shkencës, Prof. Dr. Myqerem Tafaj, ish-Ambasadorit të SHBA-së në Tiranë, Arvizu, ajo nuk ishte thjesht një surprizë, por një vlerësim i madh, të cilin vetë Ambasadori Arvizu atëkohë e quajti vlerë mbi vlerat. Në atë kohë ishte dhe një shkëputje nga një shkrim i autorit Kastriot Marku që përblihte si më poshtë: “Me rënien e regjimit komunist dhe hapjen e vendit, kishte mundësi shumë më të mëdha kërkimi, hulumtimi dhe studimi nëpër galeri, muze, biblioteka, arkiva dhe koleksione private të ndryshme në qendra kryesore të artit botëror në shumë vende të botës, si Paris, Romë, Londër, Athinë, Nju Jork dhe deri në Shën Petërburg (në British Museum, Victoria and Albert Museum, Wallace Collection në Londër, në Art Museum në Mançester, në Musée du Louvre e Muse d’Orsay në Paris, në Metropolitan Museum of Art në Nju Jork, Houghton Library në Harvard, Muzeun Ermitazh në Shën Petërburg e Galerinë Tretjakov në Moskë, në Muzeun Uffizi në Firence, në Galerinë e Arteve Moderne në Romë, Muzeun e Soloturnit në Zvicër, Benaki Museum në Athinë) etj., duke siguruar kështu të dhëna të mjaftueshme për enciklopedinë me temë shqiptare” (Marku, Gazeta “Shqip” 2013).

Sipas këtij artikullshkruesi “Nga 118 autorë që kishte përfshirë në botimin e parë, tash në këtë botim enciklopedik, numri i tyre shkon në 1250 piktorë, skulptorë dhe grafistë, ndërkohë që numri i riprodhimeve është 1112 copë. Enciklopedia ka gjithsej 871 zëra/njësi enciklopedike të zgjedhura nga mijëra vepra

arti nga një arkiv personal, që sikurse e përmend autori shkon në mbi 1400 dosje dhe 7000 njësi arkivore, çfarë dëshmon një punë të pallogaritshme hulumtuese kërkimore dhe sistemore, pas së cilës qëndrojnë 40 vite të tëra pune.” (ibid). Sikurse shkruhet, Enciklopedia “Shqiptarët në artin botëror” përmban: “Studime mbi ndikimin e shqiptarëve në artin botëror, si artistë dhe si figura të paraqitura në art; Dokumente dhe materiale arkivore të rralla, duke përfshirë piktura, grafikë, dhe fotografi nga artistë të huaj dhe shqiptarë; Piktura e huaj me tematikë shqiptare, që përshkruajnë figura, peizazhe dhe skena nga kultura dhe historia shqiptare; Biografi dhe analiza të thelluara të artistëve shqiptarë, të cilët kanë kontribuar në skenën ndërkombëtare të artit.” Jo më kot kjo Enciklopedi u bë fituese e Çmimit Special “KULT 2013”.

Duke parë punën e madhe të këtij autori ndër vite, shkrimet e tij të shumta, paraqitjet akademike e shkencore, duke parë këtë enciklopedi në këndin e saj meritore, mund të themi se Enciklopedia “Shqiptarët në artin botëror” është një studim, jo vetëm me karakter kombëtar, por edhe ndërkombëtar të artit gjithëkohor, që ka vendosur si kryefjalë Shqipërinë dhe shqiptarët, duke hedhur një vështrim kritik në punën e artistëve të njohur në këtë drejtim dhe duke eksploruar tendenca dhe lëvizje të gjera me vlera ndërlidhëse, ndërkombëtare. Libri merr si temë qendrore ndikimin e punëve në fatet e mohuara, që natyrisht me forcën që kanë artet pamore kanë synuar të bëjnë atë që mbetet e pavdekshme. Diskutohet dominimi i këtij arti që ka bërë shqiptarët të kenë dhe ata vendin kohor, në kohën kur ishin lënë të braktisur e

në harresë të plotë. Përveç kësaj, enciklopedia ka veçori të ndjeshme e të thella disa dhe të panjohura më parë mbi artin që gjuhëzonte me art kohërat dhe ngre lart vlerat e ekzistencës dhe vetë jetës si një dëshmi madhështore e përkushtimit të Prof. Dr. Ferid Hudhrit dhe një trashëgimi e vyer për brezat e ardhshëm.

Duke përfunduar dua të shtoj se duke patur në Bibliotekën personale një vepër të tillë, sikurse është dhe mbetet e patjetërsueshme, Enciklopedia “Shqiptarët në artin botëror”, natyrisht ke autorësinë e këtij hulumtuesi të madh shkencor, Prof. Dr. Ferid Hudhri, por dhe mbi 1250 autorë në 871 zëra dhe artikuj, të ilustruar me 1112 vepra arti nga dora dhe vëmendja e tij, dhe që vepër kaq domethënëse që u botua në 100-vjetorin e shtetit shqiptar. Dhe natyrisht me fjalën e ish-Kryeministrit të Shqipërisë, Aleksandër Meksi, që shprehet qartë se “Tashmë shqiptarët punojnë e studiojnë kudo në botë dhe zbulimi i veprave të tilla është me të vërtetë një detyrë fisnike. Sidoqoftë kjo i takon së ardhmes; tani le t’i gëzohemi kësaj veprë të bukur dhe të urojmë autorin për kënaqësinë që na dha.”, ajo që shkon përshtat si thirrje publike është që ndërsa të huajt e kërkojnë dhe e klikojnë në British Library, shqiptarët e kudondodhur duhet ta kenë atë në duart e tyre që të tregojnë vlerat e tyre si shqiptarë, në artin global.

SUPERMARKETI I SHQIPTARËVE

Natyrishit miqtë e shqiptarëve janë të shumtë. Sikurse ndodh me turqit ndjeshmëritë mes dy komuniteteve janë të shtrenjta, ata gjithnjë quhen vëllëzër. Kështu ndodh kur viziton supermarketin Dicle në Finchley Road. E aty gjithnjë ke miq të vetvetes, miq të shqiptarëve të sotëm e të djeshëm. Një nga ta është dhe z. Ibrahim Aĝcagül, babai i pronarit të Dicle në Finchley Road, zotit Ali, dhe një biznesmen me emër në kohë të ndryshme, që natyrishit na jep shumë gjëra të mirëfillta dhe në kohë reale. Një bisedë me z Ibrahim Aĝcagül udhëton në dimensione të shumta. Dhe natyrishit pikëtakimi është respekti dhe trëgta e sinqertë. Ai gjithnjë i do shqiptarët dhe i ka ndihmuar mjaft familje shqiptare në mënyrë humane të disa raste, sikurse ka qenë një rast i vërtetuar nga ne. Kështu ai jo vetëm me këtë por dhe me edukatën që i ka dhënë të birit, atë familjare dhe tregtare të përkushtimit ndaj vlerës dhe respektit është bërë gati një qendër për shqiptarët e asaj ane londineze.

Dhe shqiptarët më shumë se kurë frekuentojnë, bëjnë blerje dhe pëlqejnë si gjithnjë ushqimet e përbashkëta në këtë supermarket, ku nuk mungojnë dhe ato nga Shqipëria, që tashmë janë të shumtë. Duke ditur se marrëdhëniet tregtare midis Turqisë dhe Britanisë së Madhe kohët e fundit kanë marrë një dimension të ri, edhe vlerat e tregëtisë kanë marë konsideratë të jashtëzakonshme mes komuniteteve. Veçanërisht në teknologji dhe inovacion, partneritetet po zhvillohen ndërkohë që sipërmarrësit turq gjejnë mundësi të rëndësishme



DICLE
SUPERMARKET



Supermarketi i Shqiptarëve

në MB. Sipas Kenan Poleo, Konsullit të Përgjithshëm Britanik në Stamboll, këto mundësi shërbejnë si një urë për sipërmarrësit turq për të rritur bizneset e tyre dhe për të hyrë në tregjet globale. Ja një pamje gjithëpërfshirëse nga Konsullata e Përgjithshme mbi atë që i pret sipërmarrësit turq në MB.

Me këtë rast edhe biseda e lirë me z. Ibrahim Aĝcagül dhe me

vetë z Ali Aĝcagül na përforcon atë që lexojmë tek mesazhi i Kenan Poleos, që përkthehet në këtë mënyrë: "Sipërmarrësit kanë potencial të madh në MB. Ju mund të përdorni mundësi të bollshme financimi dhe një ekosistem mbështetës duke marrë pjesë në ngjarje si Java e Teknologjisë në Londër.

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë

Për të forcuar më tej marrëdhëniet tregtare të vazhdueshme midis Turqisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, një Marrëveshje e re e Tregtisë së Lirë (MTL) po negociohet midis dy vendeve. Duke dhënë informacione për këtë marrëveshje, Poleo thotë, "Prioriteti ynë është të nënshkruajmë një marrëveshje që do të sigurojë qarkullim më të lirë të tregtisë dhe shërbimeve. Ne do të fokusohemi në sektorin e shërbimeve dhe teknologjisë."

Diversiteti Kulturor dhe Sipërmarrja

Një nga avantazhet e të bërit biznes në MB është diversiteti kulturor. Poleo thotë: "Mbretëria e Bashkuar është me të vërtetë një vend global. Është një vend ku mund të gjesh kultura të ndryshme dhe të ndihesh i sigurt dhe i mirëpritur."

Këtu, sipërmarrësit jo vetëm që rrisin bizneset e tyre, por gjithashtu marrin pjesë në ngjarje të pasura kulturore dhe zgjerojnë rrjetin e tyre duke takuar themelues të tjerë. Kështu bisedat tek miqtë e shqiptarëve në supermarketin Dicle kanë gjithnjë një domethënie të madhe, që mbetet tek realiteti, reciprocitetit dhe respekti reciprok.



46 BIRCHINGTON ROAD
NW6 4LJ

Restoranti I SHQIPTAREVE

Restaurant Bar "Imperial"

"Shijoni shijet e pjatave tona të shkëlqyera, ku çdo
kafshatë tregon një histori të shijshme."



Kualitet

Dasma

Ne ju ndihmojmë në
perfeksion



Cilësi

Festime

Ju a bëjmë më festive
festën tuaj



Pastërti

Familjare

Ne jemi si një familje
ndaj e dimë
familjaren

Rezervo



020 7624 1385

EDUART BALA: PROFESIONALIZMI PËR DËRGESAT TUAJA

Ju njoftojmë se kompania që drejtohet nga Mondri, që është dhe mbetet kompania më e sigurtë dhe më profesionale e transportit të mallrave nga Anglia drejt Shqipërisë dhe anasjelltas, do të kryejë destinacionin e saj përkatës të radhës duke grumbulluar mallrat në datën 26 tetor 2023 në këto qytete britanike: Birmingham, Luton, Banbury, Oxford, Coventry, Northampton, Manchester, Leeds, Sheffield. Po ashtu ju njoftojmë se nisja e destinacionit përkatës nga Shqipëria drejt Anglisë bëhet në datën 5 Nëntor 2023. Për më shumë informacion kontaktoni drejtuesit e kësaj kompanie në celularin që jepet në fund të këtij shkrimi.

Mjaft kompani transporti e nisin me një slogan sikur janë qindra vjeçarë në këtë profesion të ri të tyre. Dhe më së shumti duan të theksojnë se kanë kryer dhe transporte të mëdha, kur dihet se si njëra dhe tjetra janë vetëm tentativa dhe lojëra fjalësh.

Kompania që drejtohet nga Eduard Bala (Mondri) mbetet më e saktë dhe me një eksperiencë të gjatë, natyrisht jo vetëm në Shqipëri dhe Angli dhe në destinacione të tjera ndërkombëtare në fushën e transportit ndërkombëtar të mallrave dhe mjeteve të ndryshme, ofron për të gjithë klientët e saj një shërbim të kompletuar dhe sigurt transporti i destinuar mbetet prioriteti dhe profesionalizmi, besimi dhe konsiderata efikase.

Siguria, shpejtësia dhe garancia e punës së zhvilluar ndër vite ka bërë që sot shumë bashkëathetarë dhe miq, të tjerë të lidhur me Atdeun tonë të dashur dhe mjaft anglezë madje që kanë shkuar të

eksperiencia e saj dhe nga aktiviteti serioz, po aq dhe nga respekti, nga përkushtimi dhe përgjegjësia e plotë gjatë gjithë procesit të grumbullimit të mallit deri në dorëzimin e tij në destinacionin final, mbetet

standarteve të një shërbimi transporti modern dhe efikas, me një garanci, mosprishje të mallrave, dhe me dërgimin pa probleme të tyre. Vizioni natyrisht mbetet qartë, të vazhdoj të mbetet një kompani lider i padiskutueshëm në transportin e Mallrave nga Britania e Madhe dhe vende të tjera të Europës drejt Shqipërisë dhe anasjelltas.

Kjo kompani funksionon me furgonë të posaçëm për këtë punë dhe me dy drejtues makinash të sprovuar në mjaft vende të huaja.

Nëse jeni duke kërkuar për një kompani cilësore, efektive, transparente, kompetente, të besueshme dhe profesionistësh, atëherë kjo është zgjedhja e duhur dhe e domosdoshme në çdo kohë.

Me këtë transport, e gjitha që ju dërgoni dhe prisni të merrni në destinacionin tuaj është në dorë të sigurtë dhe me garanci të plotë.

Duhet theksuar se mbi 50kg i marrin dhe i dërgojnë në destinacion.

Respekt-Shpejtësi-Saktësi-Garanci-Kualitet

SHPEJT
SAKTË - RESPEKT

BEST PRICE!

TRANSPORT MALLRASH: ANGLI-SHQIPËRI & SHQIPËRI-ANGLI

Mbi 50kg i marrim dhe i dërgojmë në destinacion.

- ANGLI:
• +447395287400
- SHQIPËRI:
• +355 68 3676859

VLERA PROFESIONALE

SAKTËSI - KURSIM

RESPEKTI NDAJ KLIENTIT
NA PROVONI



Respekt-Shpejtësi-Saktësi-Garanci-Kualitet

investorë në Shqipëri, po aq dhe imigrantët që jetojnë, punojnë dhe studiojnë, prej shumë vitesh në Britani të Madhe dhe në Europë kanë ardhur në pikën më të mirë të mirëkuptimit të besojnë transportin e mallrave të tyre drejt Shqipërisë.

Duam të themi se kjo kompani e njohur tashmë nga

konkurrese dhe në çmime.

Ajo mund të kontaktohet në numrat e telefonit ose në WhatsApp, Viber, Facebook, Instagram dhe e-Mail për tu informuar mbi datat dhe lokacionet e grumbullimit dhe shpërndarjes së mallit. Misioni i kësaj kompanie është të vazhdoj rrugën e suksesit në vijimin dhe përmbushjen e

TRANSPORT MALLRASH:
ANGLI-SHQIPËRI &
SHQIPËRI-ANGLI

ANGLI: +447395287400

SHQIPËRI: +355 68 3676859

KUR “SHKOLLA E JETËS” UL NË FRON DISKURSIV HULUMTIMIN “GJUHA E NËNËS”

Një emër i ri i shtohet emrave të krijuesve dhe hulumtuesve shqiptarë që jetojnë, punojnë dhe angazhohen përditësisht në Mbretëri të Bashkuar. Është Sokrat Hodo, i lindur në Tërbaç të Vlorës historike në Shqipëri, që si një njeri i lirë nuk identifikohet me shkollimin a profesionin e tij, por me eksperiencën jetësore, zellin dhe pasionet e tij vjen si një autor i ri në fushat e etimologjisë, misticizmit dhe semiotikës me librin “Gjuha e Nënës”. Si një nxënës i përjetshëm i pëlqen të eksplorojë dhe mësojë misteret që fsheh kozmosi, natyra, toka, njeriu, fjala. Ai sikurse e cituam më lart, që në hyrje banon në Londër dhe punon si një punonjës i vetëpunësuar. Madje në kënde të sinqerta e të thella sinqeriteti, ndërsa ka prurë në duart e lexuesve librin “Gjuha e Nënës” autori pranon thellë në këtë pikë respektin e punës së tij të madhe, të respektuar e të ndjeshme në shumë vlera e nga shumë kënde. Të ngacmohet një temë të tillë është njëra ënë, se lind kureshtjen dhe debatin, por të sjellësh një libër të një vlere të tillë, është padyshim guri në duart e profesionistëve, në duart e atyre që duhet ta latojnë mjeshtërisht dhe shkencërisht, që ta bëjë diku dhe ndoshta për dikë një gur të shenjtë themeli të ndërlihdjeve diskursive gjuhësore.

Sikurse dihet nga studime dhe studiues të shumtë, por dhe nga ndërrmarës të syreshme inisiative, dhe hulumtimesh të ndryshme në gjuhësi, është një deklaratë e pranuar përgjithësisht se gjuhët e botës nuk ekzistojnë të izoluar nga njëra-tjetra. Dihet gjithashtu se popujt kontaktojnë njëri-tjetrin dhe krijojnë lidhje kulturore, historike, fetare, politike dhe ekonomike. Si rezultat i këtyre kontakteve, elementë nga një gjuhë depërtojnë në një tjetër. Rastet e huazimit mund të jenë nga nivele të

ndryshme të sistemit gjuhësor – fonetik, morfologjik, leksikor dhe sintaksor, por më të zakonshmet dhe tipiket janë huazimet leksikore. Kontaktet


të titullit shumë domethënës “Gjuha e nënës” me interes më të madh paraqet qasja dhe trajtesa e mjaft fjalëve të retrospektuara e të përpunuara

dhe Simboleve të saj, Nënës, kujtimet të Petro Zhejit, vepra e të cilit ndikoi direkt në këtë libër, dhe shumë njerëzve që nuk kanë lënë emër mbas, por kanë lënë gjurmë mbi të cilat ka vazhduar të ecë qytetërimi deri më sot (Hodo, po aty).

Në këtë ndërrmarje të sinqertë e të përkushtuar në vite, vëmendja e autorit nuk tërhiqet nga emrat e përveçëm, që tregojnë njerëz dhe kanë formante rrjedhore nga gjuhë të tjera që janë pjesë e një formati të njohur, apo të panjohur më parë, që shqyrton prejardhjen nominale në gjuhën bashkëkohore, por shkon në themel tek Gjuha Shqipe që sipas tij “bëhet çelësi për të zhblokuar enigma të pahapura te ajo vetë, te gjuhët e tjera (që ruajnë dije po aq të rëndësishme) dhe dimensioneve të vetë jetës, pasi ajo është shprehje esenciale e koshtencës universale (Po aty, 2024: 4). Dhe kështu qëllimi i Hodos, nuk është thjesht të evidentoj dhe të evidentohen, por të përcaktohen llojet dhe modelet e fjalëformimit, produktiviteti i tyre, semantika e formantëve, karakteristikat leksikore dhe gramatikore të formave bazë motivuese, marrëdhëniet sinonimike, në të cilat përfshihen nga njëra anë derivatet dhe, nga ana tjetër, formantët.

Parë në këtë rrjedhë këtë libër, të cilin autori e quan të ardhur nga “Shkolla e jetës”, ose më saktë, kur Gjuha Shqipe shërben në këtë pikë “si një esencë e fortë” mes këtyre “kontrasteve” që ruhen në shishe të vogël pret të përdoret në rast nevojë, pra ku ajo [Gjuha Shqipe] i afrohet më tepër se çdo gjuhë tjetër asaj eksperience njerëzore që populli e quan “Shkolla e Jetës” dhe ku të dhënat hulumtuese për numrin e fjalëve të analizuara e të ristrukturuara nga rrënjët e supozuara janë të ndryshme, semantika e... (vijon në faqen 13)

GJUHA E NËNËS



Sokrat Hodo

Kujt i pëlqejnë: etimologjia, misticizmi, e reja mund ta gjejë në libraritë:

Vlorë:

Librari Endri (Bulevardi I.Qemali)
Librari Alketi (Rr. Kosova)

Tiranë:

Plisi (Kombinat)
Art's Librari (Bulevardi Zogu i I)
Tiranabok Librari (Rr. Sami Frashëri)
Lexim të këndshëm dhe Faleminderit!

www.fjalaelire.com

shekullore të popullit shqiptar me popujt dhe kulturat e tjera kanë çuar në praninë e një sasi të konsiderueshme fjalori me origjinë të huaj. Kontaktet shqiptare datojnë për shekuj të tërë me radhë dhe lindën nga kontaktet e shumta midis gjuhëve të folura të kohërave. Ekzistojnë teori të ndryshme në lidhje me natyrën e lidhjeve etnike dhe gjuhësore midis palëve, por ato janë kryesisht të diskutueshme.

Për qëllime të këtij libri, më saktë për arsyen e thjeshtë e të sinqertë të ndërrmarjes personale të autorit Sokrat B. Hodo, dhe nga ana tjetër

nga rrënjë dhe tema të drejtpërdrejta dhe që hererës janë mjaft të bindshme, mjaft të qëndrueshme. Vetë autori modest i një studimi të tillë të ndjeshëm shprehet në hyrje të librit: “Të flasësh për të vërtetën është si të flasësh për agun apo muzgun, për ditën dhe natën njëkohësisht.” (Hodo, 2024: 4). kështu me leximin e parë dhe me atë që ne konstatojmë më tej gjatë gjithë librit ndjejmë se autori e sheh këtë si një “kontrast natyror” (ibid). Pra për autorin e këtij libri “Ky kontrast natyror reflektohet edhe në tematikën e librit që i kushtohet të Vërtetës, Perëndisë, Gjuhës



(vijon nga faqja 12) ... formantëve të derivativëve të gjuhës prodhuese në fjalëformim të përmbajtjes së gjuhës shqipe (në emrat e emërtuar) e bën jo thjesht një projekt të guximshëm, por një projekt të rëndësishëm dhe që duhet të shihet si një produkt me vlerë të konsiderueshme. Duhet theksuar që në këtë pikë se hulumtimi dhe produkti i këtij hulumtimi të autorit në konsideratë nuk duhet ngatëruar me kulturën shpirtërore të parë si një sistem semiotik, edhe pse hyn thellë në marrëdhënie komplekse me sistemin e gjuhës, sepse kultura shprehet edhe përmes formave simbolike që përcillen brez pas brezi. Këto janë mbi të gjitha simbole gjuhësore që bazohen në simbole kulturore, situata tipike dhe dukuri që lidhen me arketipet e realizuara në kulturë. Sipas thelbit të kontekstit kuptojmë se gjuha është një pasqyrë në të cilën simbolet kulturore pasqyrohen në formë verbale. Për shembull, po të kuptojmë se shprehja “deri në pikën e fundit të gjakut” simbolizon përkushtimin, qëndrueshmërinë dhe heroizmin, që janë arketipe të rëndësishme në kulturë, duke u kthyer tek tema që trajton “simboli më i vogël” i autorit, pra duke u rikthyer përsëri te tema, “fakti që në çdo gjuhë, fjala dhe vetë simboli gjendet cilësisht i tkurrur deri në një ideogramë a gërmë të vetme do të thotë se ato kanë peshë specifike të lartë dhe se janë nënvlerësuar deri më tani. Në gjuhën shqipe duket lehtë superioriteti në këtë drejtim kundrejt gjuhëve të tjera të emërtuara si silabike apo edhe morfo-silabike për disa fakte” (Hodo, 2024: 92).

Pra le ta bëjmë dhe një herë më të thjeshtë, pra sikurse e kuptojmë simbolikën e kuptimeve mbartëse, ta bëjmë dhe këtë kuptimin e simbolit të vogël. Shprehja “më ka ngecur në fyt si halë peshku” është simbol i diçkaje a dikujt që më shqetëson, më mundon. Ky simbol është një pasqyrim i një situatë tipike në jetën e një personi, e cila është

shfaqur në frazeologji, duke marrë një kuptim metaforik dhe tipare tipizimi. Në njësitë frazeologjike të shënuara kulturalisht (në tekstin e mëtejshëm), d.m.th. në ato ku ka një komponent kulturor vërehet e njëjta gjë. Një pjesë e rëndësishme e kujtesës kulturore të çdo bashkësie gjuhësore është e koduar në frazeologji. Koncepti i simbolit zë një vend të rëndësishëm në studimet kulturore, ku shihet si një shenjë e një lloji të veçantë. Thelbi semantik i kulturës është i ngulitur në simbole. Shumë autorë përdorin termin “kod” në vend të “simbolit”, të cilin mund ta citojmë dhe si sinonim në mjaft raste, por në rastin e trajtesës së simbolit të vogël të Hodos duhet më shumë mirëkuptim. Hodo na e thjeshton punën sqaruese në këtë pikë. Ai sqaron kështu: “Së pari: në shqip 9 gërma prej 36 janë fjalë tërsisht fjalë të pavarura ku 7 prej tyre janë zanoret - a, e, ë, i, o, u, y dhe 2 bashkëtingëlloret ç, s.

Ku:

a - është lidhëz, pjesëz, emër, pasthirmë

e- është nyjë, përemër, trajtë e shkurtër e përemrit vetor, lidhëz, pjesëz, pasthirmë

ë- pjesëz, pasthirmë, përdorime të ndryshme

i- nyjë, trajtë e shkurtër e përemrit vetor dhe pronor

o- lidhëz, pjesëz, pasthirmë,

u- përemër, pjesëz, pasthirmë, trajtë e shkurtër e përemrit vetorë,

y- pasthirmë

s- pjesëz mohuese

ç – përemër pyetës, ndajfolje, pjesëz, përemër lidhor (Ibid).

Autori më tej duke na dhënë një analizë të detajuar sipas këndvështrimit të tij, ku me sugjerimin e gjetur “një shkronjë përdoret si një fjalë” shkon më thellë në thelbin e produktit simbolik të fjalëformimit.

Ndërsa në produktin e gjuhëformimeve një temë me interes është natyra e simboleve si njësi e gjuhës




dhe e kulturës, tek ky hulumtim zë një vend të rëndësishëm “Simboli më i vogël” (Hodo, 2024: 92). Ja si shprehet vetë ai: “Teoritë që kanë gëluar prej dekadash rreth gjuhës shqipe duket sikur nuk kanë të rreshtur. Shpënia te simboli e fjalës sipas teorisë së P. Zhejit duket se e ka sosur filozofinë e gjuhës dhe faktikisht ai e ka konsumuar pothuaj atë. Serioze është edhe teoria e embriomorfemave të A.Dalipaj e cila në mënyrën e vetë tregon dhe gjen vend në etimologjimin e fjalëve të çdo gjuhe duke e konsumuar atë në një tjetër mënyrë. Kjo, falë dimensioneve të shumta që ka gjuha” (Ibid). Me këtë nëkuptojmë se për frazat e grupeve me kuptim simbolik është emërtimi tipik i një objekti sipas kuptimit të caktuar në një sferë të caktuar kulturore, ku lindin më pas frazat e strukturës së brendshme. Kështu mbi bazë të kësaj vetë simbolika e një numri frazash të vendosura bazohet në simbolikën e strukturës së brendshme. Në raste të tjera, simbolika e frazave të vendosura është shenjë kombëtare që njerëzit kanë zgjedhur pikërisht këto imazhe për të përcjellë kuptimin universal. Në raport, simbolika e frazave të vendosura është konsideruar kryesisht në frazat e grupeve antroponimike dhe ngjashmëritë fikse. Kjo risi zgjon dhe lind nevojën e mëtutjeshme që të studiohen simbolet somatike dhe simbolet-zoonimet, që mes kësaj të tregohet paqartësia e disa simboleve. Prandaj autori mes një morie shembujsh në një zbërthim adekuat, qoftë dhe në të folurën toskërishte zbulon se “shqipja jo vetëm që është një gjuhë morfo-silabike dhe simbolike por mund të jetë e vetmja gjuhë e gjallë që e përfaqëson më së miri këtë emërtim” (Hodo, 2024: 99).

Meqenëse semantika e derivateve me formantët e trajtuar nga autori në gjuhën shqipe tashmë janë paraqitur në prezantimin e gjerë e të shpjegueshëm imtësisht nga Hodo, këtu shihet dhe ana tjetër e tiparit

shkencor ku duhet të gjithë të përqendrojmë vëmendjen tonë në përmbajtjen semantike të morfemave të përmendura në gjuhën shqipe. Gjithashtu janë dhe prapashtesat e trajtuara e të mara në konsideratë shfaqin mundësi të gjera kombinuese, me më produktivitetin formantin derivativ. Si pasojë nëkuptojmë se derivatet kanë emra, mbiemra, numërorë, folje dhe ndajfolje si baza prodhuese (motivuese) dhe në këtë proces vërehet një çekuilibrë, numri i formimeve desubstantive është më i madhi. Autori merr “rrugëtime” shumë të gjata historike dhe ekzistenciale, duke u futur thellë mes hieroglifëve egjiptiane dhe shumë alfabeve të gjuhëve që e përmbajnë këtë shenjë, të cilën ai e shikon si pothuaj “të përbotëshme për nga përdorimi i tingullit të saj”, për të na dhënë udhë të lehta se si të mirëkuptohet simboli (Fq 120). Sipas autorit pra fjala ka nevojë për fjalë të tjera të cilat gjenden të maskuara shpesh brenda vetë fjalës qoftë ajo edhe fjalë embrionale. Ose shembuj mund të gjenden te kapitulli “K’apja e simbolit” ku k-ja fundore si fenomen ndërgjuhësor merr kuptim si një fjalë tashmë (Po aty).

Autori i sheh këto si derivate ku një “simbol i ngjitet një nucleo-je bazë, duke përfutur një fjalë të re, një koncept të ri, dhe një qelizë të re, e cila bëhet bazë, rrënjë e re për krijim fjalësh dhe konceptesh të tjera më të komplikuar e më specifike” (Ibid). Më tej, duhet theksuar se nga lexuesi i thjeshtë, leximi dhe kuptimi i menjëhershëm bëhet i ndërlikuar, pasi disa derivate kanë si bazë motivuese një leksik, ose një kombinim të një mbiemri dhe një emri (atributiv sintagmë), me të shprehur vetëm pjesën e parë të saj (Qe/ka, qetë: Këto fjalë janë bisemike dhe kanë nevojë qoftë dhe për një libër për t’i shpjeguar. Shprehja “qe si qe u bë si ka” ruan një histori disa mijëra vjeçare përbrenda. Më saktë gjithë historinë e krijimit të kësaj bote që njihet deri më sot e madje shkon te arkeotipi...

ARYA FOOD CENTRE



Supermarketi shqiptar në Gravesend me pamje të re.



159-160 Parrock St, Gravesend DA12 1ER



SALMAN ŞIRINGÜL

Arya

SUPERMARKET



“KOLA CONSTRUCTION LTD”, NJË SUKSES QË TREGON ARRITJET KUR PËRKUSHTIMI BËHET ME ZEMËR TË MADHE

Dy emra dhe një mbiemër. Tony dhe Armando Kola janë dy profesionistë të njohur tashmë në Britani të Madhe. Dy vëllezër profesionistë me pasione thujse të ngjashme në krijimin e kompanisë “Kola Construction Ltd”, por dhe dy partnerë me synime të qarta në ecjen përpara. Armando në rolin e CEO dhe Tony në rolin e Drejtorit menaxhues, tashmë kanë një pikë të përbashkët, atë që i bashkon që nga fillimi, që nga krijimi i kësaj kompanie, për ta bërë atë një lider në fushën e konstruksionit. Ndërsa, Tony luan një rol kyç në operacionet e përditshme të kompanisë, duke u fokusuar në menaxhimin efektiv të projekteve dhe sigurinë që ato

realizohen brenda buxhetit, afateve dhe standardeve të cilësisë, Armando është themeli i vizionit strategjik dhe drejtimit të përgjithshëm të “Kola Construction Ltd”. Si CEO, ai udhëheq kompaninë me një përkushtim të thellë për përsosmëri dhe inovacion. Me një përvojë të gjerë në industrinë e ndërtimit dhe menaxhimin e projekteve të mëdha, Armando ka luajtur një rol kyç në ndërtimin e reputacionit të kompanisë si një lider i besueshëm dhe i suksesshëm.

Duhet theksuar se Armando është i njohur për aftësitë e tij në disa cilësi dhe aftësi profesionale sikurse janë zhvillimi i strategjive të

qëndrueshme për rritje dhe zgjerim të kompanisë, ndërtimi i marrëdhënieve të forta me klientët dhe partnerët, fokusi në implementimin e teknologjive dhe metodave më të fundit në ndërtim për të rritur cilësinë dhe efikasitetin. Armando është një lider që frymëzon ekipin e tij me përkushtimin e tij për standarde të larta dhe përmirësim të vazhdueshëm. Ai beson se suksesi i kompanisë është i lidhur drejtpërdrejt me përbushjen e pritshmërive të klientëve.

Por kjo nuk është vetëm një vlerë që dallon Armandon, pasi ata të dy së bashku shtojnë vlerën e përbashkët të “Kola Construction Ltd”. Kështu, Tony dallohet për planifikimin dhe menaxhimin e operacioneve komplekse ndërtimore, mbajtjen e komunikimit të qartë dhe transparent me klientët dhe ekipin, sigurimin që çdo projekt të përbushë kërkesat teknike dhe ligjore, motivojë dhe të udhëheqë ekipin për të arritur rezultate optimale. Gjithashtu, Tony është i njohur për qasjen e tij të përqendruar te detajet dhe aftësinë për të adresuar sfidat e ndërlikuara me qetësi dhe efikasitet. Si bashkëpunëtor i ngushtë me Armandon, ai garanton që vizioni i kompanisë të përkthehet në rezultate konkrete dhe të matshme.

vizionin strategjik me zbatimin praktik. Së bashku, ata kanë ndërtuar një kompani që përfaqëson cilësi, integritet dhe një angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin e industrisë së ndërtimit.

Krahas kësaj po të ndjekësh diskursin e efikasitetit dhe suksesit të një kompanie ndërtimi kupton se “Kola Construction Ltd” nuk është thjesht një kompani që përqs tre pikat e lartcituara, por dhe një kompani mjaft e suksesshme. Duke ditur se një kompani e suksesshme ndërtimi karakterizohet nga një fokus i fortë në punimin cilësor, menaxhimin efektiv të projektit, komunikimin e qartë me klientët, një përkushtim ndaj sigurisë, një fuqi punëtore të aftë dhe të trajnuar mirë, planifikim të fuqishëm financiar dhe aftësi për t’u përshtatur me kushtet e ndryshimit të tregut dhe nevojat e projektit; në thelb, duke ofruar projekte në kohë, brenda buxhetit dhe sipas standardeve të kërkuara të cilësisë, duke i dhënë përparësi kënaqësisë së klientit dhe mirëqenies së punonjësve, mund të themi hapur dhe pa ndrojtje se Armando dhe Tony e kanë bërë më shumë se meritore këtë specifikë për “Kola Construction Ltd”.

Mjafton të klikosh dhe të bësh një kërkim yt thjeshtë për këta dy emra, për këtë kompani dhe punën e saj në Mbretëri të Bashkuar do të gjesh dhe do të ndjesh se “Kola Construction Ltd” është një grup specifik profesional në shumë drejtime, më saktë një fuqi estetike që mund të transformojë shtëpinë dhe hapësirat e jashtme në mënyrë tejet estetike. Për këtë “Kola... (vijon në faqen 17)

Checkatrade

KOLA CONSTRUCTION

01202 737 723
08000 385 746
WWW.KOLA.CONSTRUCTION.CO.UK

AWARDS BUSINESS TREND 2023

AWARDS BUSINESS TREND

Pra thjesht dhe qartë me „Kola Construction Ltd” kuptoni qartë se çfarë do të thonë kuotimet e mëposhtme, kur ju duhet të kërkonit për një kompani të mirë ndërtimi, citate si „Ndërtimi i besimit përmes mjeshtërisë së jashtëzakonshme”, „Ndërtimi cilësor që flet vetë”, „Përsosmëria në çdo strukturë” dhe „Një ndërtesë e shkëlqyer vjen nga njerëz të mirë dhe të gjitha problemet zgjidhen nga dizajni i mirë”. E thenë me saktë vetë „Kola Construction Ltd” me këto të thena, nxjerr në pah rëndësinë e punimit cilësor, besueshmërinë dhe një qasje të përqendruar te klienti. „Kola Construction Ltd”, mbetet një sukses që tregon faktin kur përkushtimi bëhet me zemër të madhe.

Nga kjo del qartë dhe vetë misioni i kompanisë. „Kola Construction Ltd” transformon shtëpitë me mjeshtëri cilësore, zgjidhje të personalizuar dhe shërbim të jashtëzakonshëm. Për këtë thuhet „Ne jemi të përkushtuar për t'i bërë realitet ëndrrat tuaja për përmirësimin e shtëpisë.” Dhe natyrisht del dhe vizioni i qartë dhe shumë domethënës: „Vizioni ynë është të ndërtojmë një komunitet të shtëpive të bukura, ku kënaqësia e klientit është themeli ynë.”

KONTAKTONI:

- 0800 038 5746
- contact@kolaconstruction.co.uk
- 270-272 Ashley Road, Poole, BH14 9BZ

(vijon nga faqja 16)

...Construction Ltd” do të jetë me një qasje profesionale në Olympia Londër, nga 21 marsi deri më 6 prill 2025, dhe aty do të bëhet shpallja reale dhe e prekshme, se si kjo kompani, pra mund të transformojë shtëpinë dhe hapësirat tuaja të jashtme. Ekipi i kësaj kompanie i përbërë me ekspertë të punimve rafinature, estetikë dhe shtrim artistik, modelim cilësor e dekorativ, konservatorë, peizazhe, stolisje, veshje, ose çati. Në këtë paraqitje zyrtare ndoshta do të jetë dhe një mundësi më shumë se reale që të shijohen dhe përjetohen produktet premium dhe mjeshtëria e dorës së parë të “Kola Construction Ltd”.

Jashtë kësaj, nga një bisedë disaminutëshe me njërin nga drejtuesit e kësaj kompanie, CEO-n, Armando Kola, kupton fare qartë se ata që i bashkohen “Kola Construction Ltd” nuk janë thjesht njerëz që kërkojnë të firmosin në fund të një periudhe për të mbushur xhepin, natyrisht që është një anë, por janë dhe funksionojnë dhe si një grup njerëzish krenarë që punojnë në Mbretëri të Bashkuar, qëllimi kryesor i të cilëve është të bëhen model shembulli në punën dhe profesionin e tyre, dhe njëkohësisht të inkurajojë shqiptarët që punojnë në Mbretëri të Bashkuar duke i ndihmuar ata të ndërtojnë karriera të suksesshme.

Grupi që i është bashkuar “Kola Construction Ltd” ka shumë profesionistë, dhe anëtarë të tjerë që japin shumë e shumë në punët e tyre. Dhe ndoshta dhe jashtë modestisë në një bisedë të tillë, kupton qartë se ata janë njerëz të zgjuar, dhe kanë klientë nga fusha të ndryshme, kanë klientë të mirëarsimuar, shumica e të cilëve punojnë në financa,

banka dhe industrinë e IT. Për më tepër, rreth një e treta e klientëve të “Kola Construction Ltd” mbajnë pozita të larta drejtuese. Kjo e bën akoma më të vëmendshme tërë situatën përfshirëse dhe angazhuese të vetë drejtuesve të “Kola Construction Ltd”. Ndaj dhe një nga motivimet e kësaj kompanie është i lidhur më bashkëpunimin. Në statusin e kësaj kompanie thuhet “Bashkëpunimi është thelbi i procesit tonë. Ne dëgjojmë, ofrojmë udhëzime ekspertësh dhe ju mbajmë të informuar në çdo hap të rrugës. Prisni një përvojë të qetë dhe pa stres të rinovimit të shtëpisë.”

Nga kjo del qartë dhe vetë misioni i kompanisë. “Kola Construction Ltd” transformon shtëpitë me mjeshtëri cilësore, zgjidhje të personalizuar dhe shërbim të jashtëzakonshëm. Për këtë thuhet “Ne jemi të përkushtuar për t’i bërë realitet ëndrrat tuaja për përmirësimin e shtëpisë.” Dhe natyrisht del dhe vizioni i qartë dhe shumë domethënës: “Vizioni ynë është të ndërtojmë një komunitet të shtëpive të bukura, ku kënaqësia e klientit është themeli ynë.”

Duke përfunduar mund të themi se tashmë “Kola Construction Ltd” e themeluar vetëm pak më shumë se një dekadë më parë nga vëllezërit Armando dhe Tony Kola është rritur nga një ëndërr e thjeshtë dhe me synim të qartë në një kompanitë kryesore të ristrukturimit efikas dhe bashkëkohor të shtëpive, që nisën si fillim në Dorset

ZBULO PROFESIONALIZMIN

Për këtë të fundit, mjafton të shohësh punën e madhe të „Kola Construction Ltd” do ta kuptosh qartë se çfarë rruge të qartë kanë ndërtuar të dy së bashku. Bashkëpunimi i partneritetit në këtë biznes, pra i vëllezërve, Armando dhe Tony, ka krijuar një ekip drejtues që harmonizon vizionin strategjik me zbatimin praktik. Së bashku, ata kanë ndërtuar një kompani që përfaqëson cilësi, integritet dhe një angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin e industrisë së ndërtimit.

Grupi që i është bashkuar „Kola Construction Ltd” ka shumë profesionistë, dhe anëtarë të tjerë që japin shumë e shumë në punët e tyre. Dhe ndoshta dhe jashtë modestisë në një bisedë të tillë, kupton qartë se ata janë njerëz të zgjuar, dhe kanë klientë nga fusha të ndryshme, kanë klientë të mirëarsimuar, shumica e të cilëve punojnë në financa, banka dhe industrinë e IT.

Checkatrade Trustpilot

e tashmë në shumë pika të Mbretërisë së Bashkuar. Pra, “Kola Construction Ltd” me një reputacion solid të ndërtuar mbi një kuptim të thellë të industrisë të ndërtimit, ajo qëndron në ballë të sektorit. “Kola Construction Ltd” ndjehet krenare që ofron një gamë të gjerë shërbimesh ndërtimi, të dizajnuara me përpikëri për të përmbushur nevojat unike. Angazhimi i gjithë stafit të kësaj kompanie është së pari për përsosmërinë dhe shërbimin profesional që shtëpia të mos jetë thjesht një meritim por një ndërtesë me kuptimin më të mirë estetik dhe bashkëkohor dhe të ju duket se ajo tashmë është një shtëpi tjetër, një hapësirë e përshtatur që pasqyron preferencat dhe stilin e jetesës, një trashëgimi e ndërtuar mbi përkushtimin e

vetë kompanisë ndaj cilësisë. Pra thjesht dhe qartë me “Kola Construction Ltd” kuptoni qartë se çfarë do të thonë kuotimet e mëposhtme, kur ju duhet të kërkonit për një kompani të mirë ndërtimi, citate si “Ndërtimi i besimit përmes mjeshtërisë së jashtëzakonshme”, “Ndërtimi cilësor që flet vetë”, “Përsosmëria në çdo strukturë” dhe “Një ndërtesë e shkëlqyer vjen nga njerëz të mirë dhe të gjitha problemet zgjidhen nga dizajni i mirë”. E thënë më saktë vetë “Kola Construction Ltd” me këto të thëna, nxjerr në pah rëndësinë e punimit cilësor, besueshmërinë dhe një qasje të përqendruar te klienti. “Kola Construction Ltd”, mbetet një sukses që tregon faktin kur përkushtimi bëhet me zemër të madhe.

STRUKTURAT E PADUKSHME TË “DEMOKRACISË” KUNDËR DEMOKRACISË

Sistemi, nëse do ta quanim të tillë, atë që solli në pushtet “populistët” e maskuar të Demokracisë në Europë, duket se tashmë po zbehet. Po zbehet ashtu sikurse shihet se vetë Euro-establishmenti, që e di se kontrolli i tij mbi pushtetin, më së fundi po zbehet. Dhe kështu, si një kafshë e plagosur, kjo farsë e krijuar nga vetë sistemi i parasë së pakontrolluar, po përpëlitet e po rrënkon më fort se kurrë. Pa e kuptuar është një këcënim. Është në fakt vetë kërcënim që për demokracinë evropiane të kohëve të fundit kishte ardhur nga “populistët” e maskuar, kësaj radhe, pra këtë vit nuk do të shënjohej më si një risi në vazhdim. Kjo nga vetë fakti se kërcënim tashmë do të vij nga një lëvizje e fortë, e denjë për Demokracinë dhe jo më nga një elitë e dëshpëruar e krijuar për t'i shtypur ata që sollën demokracinë në vendet e Lindjes.

Pse e themi këtë dhe ku bazohemi?

Dihet se Kryeministrja Georgia Meloni është e djathtë. Ajo është e djathtë-populiste e Italisë, që drejton “Brothers of Italy” (Vëllezërit e Italisë). Partia e saj, e cila i ka rrënjët në Lëvizjen Sociale Italiane, e themeluar nga admiruesit e Benito Musolinit, tashmë duket se nuk është më në një zë si dikur. Realiteti vjen nga komentet e shumta të krijuara në mediat italiane dhe më gjerë që nga momenti kur Kryeministri i Shqipërisë, i cili përfaqëson një parti me rrënjë të thella majtiste, iu ul në gjunjë asaj dhe realizoi disa marrëveshje të debatueshme.

Një përfaqsim logjik mund të silltet dhe me vetë Rally National, dikur Fronti Kombëtar në Francë, u

themelua nga babai i ndjerë i Marine Le Pen, Jean-Marie Le Pen, një mohues famëkeq antisemit dhe i Holokaustit (i cili vdiq pak javë më parë) dhe po aq me AfD, e cila mund të mos ketë një histori fashiste, pasi u themelua vetëm në vitin 2013, por disa nga figurat kryesore të saj duken çuditërisht të preokupuara me relativizimin e krimeve historike të Gjermanisë. Këto me sa shihet nga ajo që prezantojnë mediat janë bërë parti populiste, që



thuhet se vazhdojnë të fitojnë popullaritet.

Arsyeja pse këto parti vazhdojnë të fitojnë popullaritet nuk është sepse publiku votues është kthyer papritmas në ‘djathtas ekstreme’, por se ka nga pas financimet nga “populistët” e maskuar. Pra publiku votues ka ndryshuar?! Jo. Përkundrazi. Kjo është pjesërisht sepse ata kanë filluar t'i bashkojnë veprimet e tyre, (sa mjetas e djathtas) duke përjashtuar anëtarët me probleme dhe duke pezulluar kandidatët e dyshimtë në një përpjekje të qartë për t'u dukur më të respektueshëm (sa i sinqertë mund të jetë ky akt pastrimi, është një debat tjetër). Një shtysë edhe më e madhe është se dështimet e establishmentit politik të Evropës tani janë

kaq legjionale dhe kaq të dukshme sa që njerëzit janë gjithnjë e më të përgatitur për të goditur të huajt, madje edhe me topat e çuditshëm e të padukshëm. Shumë shpesh, populistët e tillë janë të vetmet parti që janë të gatshme të sfidojnë një status quo të mjerë, mjafton të gjendet fajtori tek Opozita, apo Kryeopozitari. Me këtë stil e metodë ata erdhën në pushtet, (në Shqipëri me “Fajin e ka Saliu”) me një stil të ngjashëm të maskuar ata po mundohen tashmë të manipulojnë edhe votat e Diasporës. Për këtë është vënë në heshtje edhe BE që kërkon të vendos me forcë censurën.

Qëllimi i perandorisë së re të censurës së BE-së

Rumania, një vend anëtar i BE-së, kohët e fundit anuloi zgjedhjet, sepse fitoi kandidati “i gabuar”. Larg nga dënimi i këtij sulmi ndaj demokracisë, liderët e Evropës heshtën. Një burrë i madh i BE-së madje vlerësoi shembullin e Rumanisë. Fakti shpjegon se ky autoritarizëm antidemokratik nuk ka ardhur nga hiçi. Elitat evropiane kanë kërkuar prej kohësh të izolohehen nga gjykimi i votuesve. Kundërshtarët demonizohen, censurohen dhe mbyllen nga pushteti. Brukseli thuhet madje do të rrëzojë qeveritë e zgjedhura nëse ato nuk arrijnë të ndjekin vijën e BE-së. Ndërsa struktura e euros dobësohet, përballet me sfiduesit populistë dhe kalbet nga brenda, sistemi i tillë po përdor mjete gjithnjë e më shumë forma autoritare për të ruajtur kontrollin e tij mbi pushtetin. Për këtë është vënë në funksionim edhe vetë qëllimi i perandorisë së re të censurës së BE-së.

Qëllimi i perandorisë së re të censurës së BE-së është të kufizojë shtrirjen

dhe fushatën e partive të ashtuquajtura populiste kryengritëse të Evropës. Brukseli i akuzon këto grupe për përhapjen e “dezinformimit” dhe “urrejtjes”, dhe këmbëngul se duhet të censurohen. Natyrisht, elitat e BE-së nuk e pranojnë se janë të përfshirë në një sulm autoritar ndaj fjalës së lirë dhe demokracisë. Si mund të kuptohet heshtja e mjaft mediave shqiptare ndaj fjalës publike të ish-Kryeministrit Arben Ahmetaj, që ndodhet në ekzil?! A është thjesht heshtje? Krejt e kundërta. Është frika nga kontrolli i parasë që u jepen mediave. Dhe kështu ata që e bëjnë këtë pretendojnë se censura është e nevojshme për të mbrojtur demokracinë dhe lirinë nga ata që ata i kanë hedhur si kërcënimin autoritar “real” partitë populiste. Ky është një fjalim i pastër i BE-së që i shkon vetëm parasë në masë.

Rrëmbim i pacipë i Demokracisë

Çuditërisht, ky rrëmbim i pacipë shkaktoi një ngritje supesh nga Bashkimi Evropian, por dhe nga udhëheqësit e Evropës. Ata që zakonisht ishin aq të prirur të paraqiten si mbrojtës të demokracisë dhe roje të rendit liberal, kanë heshtur. Në fakt, guxoj të them se euro-elitat e panë jo aq me tmerr kthesën e Rumanisë kundër demokracisë, por thjesht me miratimin e kokës. Në fund të fundit, ndërsa asnjë vend tjetër i BE-së nuk ka shkuar aq larg sa Rumania në anulimin e zgjedhjeve që sjellin rezultatin ‘të gabuar’, burokratët në Bruksel dhe partitë e krijuara në të gjithë Evropën kanë gjetur shumë mënyra të tjera për të minuar demokracinë gjatë vitit të kaluar ose parapërgatisin mjaft insinuatat dhe për zgjedhjet që po afrojnë...

SHPIRTI DEMOKRATIK



Nga Gazmend Cufaj

Shpirti demokratik më urdhëroi që ti bashkohem protestës më të fundit të demokratëve në Tiranë. E mirëkuptoj nga vetë ekzistenca se ajo që më lidh më së shumti me këtë arsye nuk është thjesht protesta. Është së pari edukata ime që më ka bërë të ndjehem i lirë dhe i vendosur dhe së dyti ajo që buron nga rrënjët e mia demokratike që në rrjedhën time ekzistente në familje. Kështu e pashë nga afër këtë protestë dhe e ndjeva nga afër vullin e pavdekshëm demokratik. E ndjeva forcën dhe shpirtin demokrat tek të gjithë në atë protestë. Dhe jo më kot them se kjo protestë ishte vërtet një peshë tjetër, një shpresë e ndjeshme. E kuptova se Protesta është një mënyrë e paçmuar për t'i thënë të vërtetën pushtetit. Gjatë gjithë historisë, protestat kanë qenë forca shtytëse pas disa prej lëvizjeve më të fuqishme sociale, duke ekspozuar padrejtësinë dhe abuzimet, duke kërkuar llogari dhe duke frymëzuar njerëzit që të vazhdojnë të shpresojnë për një të ardhme më të mirë. Fatkeqësisht, këto të drejta të çmuara janë nën sulm dhe duhet të mbrohen nga ata që kanë frikë nga ndryshimi dhe duan të na mbajnë të ndarë. Qeveritë dhe të tjerët me pushtet po gjejnë vazhdimisht mënyra të reja për të shtypur protestën dhe për të heshtur zërat kritikë. Tendencat globale drejt militarizimit të policisë, rritja e keqpërdorimit të forcës nga policia në protesta dhe zvogëlimi i hapësirës qytetare do të thotë se po bëhet më e

vështirë të qëndrosh i sigurt ndërkohë që të dëgjohe zëri. Aftësia për të protestuar në mënyrë të sigurt është një çështje që kryqëzohet me të drejtën për të qenë të lirë nga diskriminimi. Njerëzit që përballen me pabarazi dhe diskriminim, në bazë të moshës, racës, identitetit gjinor dhe shumë faktorëve të tjerë, përballen me rrezik edhe më të madh për të drejtën e tyre për të protestuar. Është thelbësore që të gjithë të mund të protestojnë të sigurt dhe pa diskriminim. Në fushatën e saj kryesore, Mbroni Protestën, dhe shpirti ynë i vendosur demokratik, angazhimi ynë si demokratë, dhe si ish drejtues i demokratëve në Barking dhe Dagenham në Londër po punojmë bashkërisht me demokratët e vendosur për të ekspozuar kur e drejta për të protestuar shkelet dhe për të mbështetur lëvizjet në mbarë botën ndërsa ato përpiqen për ndryshime pozitive. Fushata u bën thirrje qeverive të dërgojnë një mesazh të qartë se protestuesit duhet

të mbrohen dhe të heqin barrierat dhe kufizimet e panevojshme për protestat paqësore. Se kjo protestë është vetë fjala e lirë, vetë shpirti i lirë, vetë ajo që tha Prof Dr Sali Berisha: "E nis fjalën time me një përulje para jush, me një falënderim vllazëror dhe në përgëzimet e mia për të gjithë ju, për të gjithë demokratët dhe opozitarë. Në pak kohë, ne kemi bërë shumë. Le të kthehemi pak, vetëm një vit më parë, në shkurtin e kaluar, ne ishim këtu në shesh në protestën e 20-shkurtit. Lideri i Opozitës ishte I arrestuar, në kundërshtim me ligjin, në kundërshtim me kushtetutën. Dhe unë fjalën time e mbajta nga një ekran, I burgosur politik. Në atë protestë ne hodhëm themelet e çdo fitoreje që meritojmë dhe që do të kemi. Në atë protestë ne dëshmuam shqiptarëve se nga hiri u ngritëm si Feniksi. Ata që menduan që do të na mposhtin, dështuan me turp. Ne jemi të pamposhtur se ne mbrojmë kauzë të drejtë. Ne jemi të pamposhtur se ne mbrojmë

vlerat njerëzore. Ne mbrojmë lirinë, dinjitetin, familjen, kombin. Ndaj vijmë sot këtu si opozitë e të pamundurës, e bën të mundur si Partia Demokratike. Sot kemi vullë dhe flamur, jemi më të bashkuar se kurrë. Sot me 3 rezultata ndërkombëtare, jemi forca politike më e përkrahur. Sot jemi në këmbë më të vendosur se kurrë në betejë me diktaturën, do fitojmë. Historia, historia e deshi që ne të jemi e vetmja forcë politike që përmbys dy diktatura. Asgjë s'marrim ne si dhuratë. Ne gjithçka meritojmë në betejën tonë. Nderim, nderim qëndrestarëve opozitarë. Miqtë e mi, përsëri krimi dhe bota e tij është kundër nesh. Prokuroria politike është kundër nesh, por ne përsëri qëndrojmë të pamposhtur. Ne përsëri qëndrojmë si mur në fitoren tonë. Ne arritëm të bëjmë pluhur, të shembim ëndrrën e pasardhësit të xhelatit komunist, Edi Ramës dhe monstrës së njerëzimit, George Soros. Gjithçka u bë që Shqipëria të mbetet pa opozitë. Kryetari i Partisë Demokratike u vendos në arrest shtëpie."

BIG BOSS SERVICES UK LTD

BUILDING CONTRACTORS

Our services include:

- Guttering
- Painting
- Decorating
- Power Clean
- Scaffolding
- PVC Windows
- Loft Conversion
- Plastering
- Carpentry
- Roofing
- Brickwork
- Tiling
- Kitchen Fitting
- Extensions
- Bathroom Fitting

Thank you so much!

KONSULTIMI me ekspertët është ZGJIDHJA MË E MIRË për ta shmagur humbjen.

Gazmend Cufaj

big_boss_services_uk_ltd

BigBossServicesUKLtd

@BigBossServices

Tel: 020 8591 9198
Mobile: 07747 143 704 / 07883 029 474
Email: bigboss-services@yahoo.co.uk
website: www.bigboss-services.webs.com
UTR: 7168616298
CRN: 8344897
VAT NR: 215642524

Shesim apartamente në Durrës,
Tiranë dhe në
zonën e Plazhit
deri tek Mali i Robit

Kontakt:
07883029474 dhe 00355685309800

DR KRISTO PAPA: POLITIKA NUK ËSHTË NJË SPRINT, POR NJË MARATONË

Kur e thirri Edi Rama për kafe, dhe bisedoi gjatë me të, ideja nuk ishte thjesht për të më ftuar të kandidoj për deputet. Ishte bisedë e lirë. E sinqertë. Por kur ai më tha se ishte vendim i vështirë të lije Londrën, nuk qesha në fytyrë, por e kuptova si mesazh. I thashë se nuk kisha oreks, as nuk më kishte shkuar ndonjëherë në mendje të shikoja ndryhesat, por vendimi të kandidoja për një post të tillë, dhe se posti më i lartë, më i lartë që do të aspiroja (përfundimisht) është ti shërbeja popullit tim të dashur, shqiptarit tim, Atdheut tim, se jam doktor dhe jam kështu humanist që në gen.

Kristo, megjithatë, duket se ka lindur në javën e bindjes. Ai më tha se do të fitonte përvojë të vlefshme, do të fitonte shikueshmëri dhe - më e rëndësishmja! - Do të jem në gjendje të realizoj diçka kuptimplote për vendin derisa (përfundimisht) të vijë koha që unë të jem i përfshirë totalisht për të mirë në politikë.

Dhe këtë e mori si një marrëveshje. Dhe më pas e kuptuam të gjithë se e kishin zgjedhur vërtetë të jetë shtylla e këtyre lëvizjeve politike në MB.

Dr Kristo Papa, krahas shumë takimeve pa bujë e rrëmujë, pa fryrje por me intelektualizëm të mirëfilltë Perëndimor, do të jetë ditën e diel më 16 shkurt në orën 14:00 së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm të PS-së Blendi Klosin, që është njëkohësisht

dhe Deputet i kësaj partie në Oxford të Anglisë për Takimin e Diasporës në kuadër të kësaj fushate për zgjedhjet e 11 majit në Shqipëri.

Vetë poster i parapërgatitur nga Tirana me moton

natyrrshëm gjetja më e goditur.

Marrëdhëniet me kolegët nga partia janë (për ta thënë butë) të përmbajtura. Qëndron në staturën. Etij të denjë dhe kështu Dr Kristo Papa përditë e më shumë po fiton emrin e ri

ndryshe, dikush edhe mund të shaj. Por në këtë rast gabon, miq të dashur.

Pra, miq. Thjesht doja t'ju them: askush nga ne nuk është i përsosur, ne bëjmë më të mirën që mundemi.



Dr Kristo Papa

www.fjalaelire.com

Revista "Albanian Post" Britani e Madhe

"Diaspora voton" e paraqet Dr Kriston në krahun kryesor me zotin Klosi. Kësisoj të veshësh një kostum çdo ditë për politikë, natyrrshëm jashtë bluzës së bardhë të doktorit të zemrës, duket se është (pak) ferr. Nga fytyrat që e ndjekin në sallë (duke përjashtuar anëtarët e partisë), Dr Kristo njih shumë, se është mjaft popullor dhe kështu ai është

meritor edhe në politikë, edhe në këtë angazhim të ri që e bën jo krejt ndryshe, por një intelektual model në lidhjen që ka vendosur të shërbej. Dhe nuk ka ndryshim ngjyra në këtë rast, se Dr Kristo Papa është njeri me vlerë në fakt, dhe kushdo që do ta përfshinte në lista do të nderohej me emrin e tij. Dikush edhe më të mendoj

Ne jemi duke mësuar. Po bëhemi më të fortë. Ne po fitojmë përvojë. Ne punojmë si një ekip - gjithnjë e më mirë, kur vjen puna për Atdheun tonë të dashur. Ne i besojmë vetes - si vetes ashtu edhe njëri-tjetrit. Kur rrëshqasim ose humbasim praninë e mendjes - kemi dikë ku të mbështetemi.

Mos harroni miq se për Dr Kristo Papa, që ia njoh dhe prindërit e tij të shkëlqyer: politika nuk është një sprint, por një maratonë. Dhe një maratonë kërkon një lloj tjetër të muskujve. Ne stërvitemi çdo ditë, duke mësuar se si t'i zhvillojmë ato. Mos u dëshpëroni dhe mos u mërzitni. Nuk është e vërtetë që asgjë nuk ndryshon, thjesht duket kështu. Nën sipërfaqen në dukje të qetë të vendit të pushtuar, gjithçka po digjet - dhe herët a vonë do të vlojë. Dilni dhe rregjistrohuni dhe dilni dhe votoni. Pastaj përsëri. Dhe përsëri. Dhe përsëri. Rezultatet do të vijnë, por kërkohet durim. Dhe qëndrueshmëri. Dhe një kokë esëll. Dhe karakter, shumë karakter, sikurse është vetë vlera e këtij intelektual me emër e me zemër. Një njeri mbi të gjitha e familjar model.


I QOFTË SHPIRTI NË PARAJSË DHE NGUSHËLLIME FAMIJARËVE DHE TË GJITHË MIQVE TË SAJ.

Luljeta Nuzi, një nga aktivistet e hershme të Komunitetit shqiptar në Britani të Madhe, themeluese dhe drejtuese e shoqatës “Shpresa Programme” ka ndërruar jetë, pas një beteje të madhe me një sëmundje të pashërueshme, duke lënë pas një shërbim të madh komunitar dhe familjen e saj të mrekullueshme.

Në lotë janë përfshirë aktivistët, miqtë dhe vullnetarët sikurse të gjithë ata që e kanë njohur nga afër.

Luljeta Nuzi ishte fituese e çmimit të nderit në vitin 2012. Kur Luljeta erdhi në Londër nga Shqipëria në vitin 1999 me familjen e saj që kërkonte strehim, ajo ishte e izoluar dhe e dëshpëruar për të mësuar gjuhën angleze. Një përzierje zemërimi dhe mirënjohjeje e motivonte atë të bënte punë vullnetare - zemërim, sepse ishte keqinformuar për mbështetjen që do të gjente dhe mirënjohje, sepse një projekt lokal e ndihmoi të ecte përpara me forcat e saj. “Gjithçka kam mësuar, e kam ndarë me komunitetin tim”, thoshte ajo dhe në vitin

2001 themeloi Programin “Shpresa”. Në kohën që ajo arriti me punë të madhe, organizata kishte nëntë të punësuar, 52 vullnetarë aktivë, ofronte shërbime në shtatë bashki dhe bën fushata në nivel kombëtar. Modeli i integritit të Shpresë-s, të cilin Luljeta e ndanet lirisht, shpesh duke mentoruar organizata të



tjera të komunitetit, ishte të punojë në partneritet për t'i bërë shërbimet të aksesueshme dhe të krijojë të reja vetëm atëherë nëse askush tjetër nuk mund të ndihmojë.

Propozuesi i saj thoshte për të: “Në zemër të Shpresës është një besim që komunitetet mund dhe e sjellin vetë ndryshimin. Shpresa, nën udhëheqjen e Luljetës, ka ushqyer një brez personash të rinj shqipfolës të angazhuar, qytetarë aktivë dhe me shumë arritje. Kjo është një arritje e jashtëzakonshme dhe hap një shteg për grupet e tjera të refugjatëve dhe të emigrantëve”.

I qoftë shpirti në Parajsë dhe ngushëllime familjarëve dhe të gjithë miqve të saj.



**„Hilal Food Centre“ në Kilburn High Road
„shtëpia“ e shqiptarëve**



“HILAL FOOD CENTRE” NË KILBURN HIGH ROAD “SHTËPIA” E SHQIPTARËVE

A ka dikush tashmë nga shqiptarët e Londrës që nuk e njeh pronarin e “Hilal Food Centre” në Kilburn High Road. Natyrisht që mund të jenë fare të pakët ata që nuk kanë bërë rrugëtimin e tyre në supermarketin në fjalë për të blerë ushqimet dhe produktet shqiptare, dhe që nuk e kanë ndjerë të flas me ta si vëlla, si mik,

si shqiptar i vërtetë. Ky është një fakt. Ky është një realitet. Dhe më tej sa herë e kemi parë vetë këtë mik të sinqertë e të vërtetë të shqiptarëve që të u vij në ndihmë njerëzve të thjeshtë, vetë familjarëve.

Në një kohë të tillë kur çdo gjë shkon në rritje, kur çmimet të japin një tronditje, respekti i tij mënjanon fitimin dhe gjithnjë u bën ulje. U bën ulje dhe mikpritje. Është i tillë i lindur nga vetë jeta, i rritur nga vetë eksperiencia. Ndaj ata që e njohin, dhe ata janë shumë e shumë gjithnjë thonë se e kanë vëlla, e kanë mik, e kanë njeri të zemrës së tyre. Kjo na bën të ndjejmë thellë respektin që

na shfaqet si një material i shtrenjtë i formës më të lartë diskursive.

Tashmë gjithkush e di se “Hilal Food Centre” në Kilburn High Road është në kuptimin më të mirë figurativ “shtëpia” e shqiptarëve. E themi këtë se aty sipas proverbit shqiptar, “gjen dhe qumësht dallëndysheje”. Kjo gjë nënkupton faktin se që nga krijimi, që nga fillimi i këtij supermarketi nën drejtimin

e tij kishte një pasqyrë të qartë të jetës shqiptare, të kuzhinës shqiptare, të nevojave që kanë familjet shqiptare në Londër. E kështu aty nis që nga kripa e mbaron tek produkti më i ri që prodhon e sjell në sy të shqiptarëve dita.

“Hilal Food Centre” në Kilburn High Road “shtëpia”

është një Realitet Shqiptar. Me optimizëm e doza inkurajuese çdokush tashmë vlerëson agrobizneset shqiptare me nota maksimale, duke i cilësuar impresionuese dhe mahnitëse, dhe për vetë faktin se ato janë burimi ku merr jetë kjo sfidë e madhe e ushqimit dhe produktit shqiptar që vjen e konsumohet në ishullin

të tjera, sidomos të Ballkanit. Ndaj është mirë që piku i sezonit të prodhimit të fruta-perimeve të shihet mirë nga instancat përkatëse që të ketë më shumë hapësirë ligjore dhe në Mbretëri të Bashkuar. Përshembull shalqin, pjepër, mollë, dardhë, fiq, rrush, domate, kastraveca, kunguj, patëllxhanë e specia, mashurka e bamje shqiptare nëse do të hynin në sezon në Londër natyrisht do të ishin një nga pikat ku do të sfidoheshin dhe më të fortët. Të gjitha këto fruta e perime janë pjesë e menisë sonë të përditshme, ndaj duhet me patjetër që të krijojnë udhë të reja ligjore drejt Britanisë.

Duke parë faktin se nga viti në vit, prodhimet shqiptare të fruta perimeve po shndërrohen në më të kërkuarat e tregjeve europiane për shkak të cilësisë së certifikuar të tyre ashtu si edhe shijes së vërtetë të tyre, ato duhet të jenë padyshim dhe në Britani të Madhe. Kur dihet fakti se eksporti i fruta-perimeve shqiptare (megjithë luftën për konkurrencë nga vendet fqinjë të

Shqipërisë) është konsoliduar dhe sa vjen e rritet, në tregun e brendshëm shqiptar ka një kaos përse i përket vendeve ku shiten prodhimet vendase dhe ku është më e garantuar cilësia e tyre, ndaj duhet parë mundësia e lidhjeve tregtare jashtë, sidomos në BM. Kjo do ta shtonte akoma më shumë lidhjen e padiskutueshme tashmë të shqiptarëve me “Hilal Food Centre” në Kilburn High Road.

Hilal Food Centre mbetet preokupimi im komunitar, vendi ku ushtrij më të mirën e mundshme që të zbatoj parimin. Eshërbimit të kulturuar, vlerës dhe respektit. Është supermarketi ku natyrshëm do të gjeni më të mirën e kërkuar, duke konkuruar e duke u përkushtuar.

Mirë se vini!

*Investoni kohën tuaj me
mençuri, është burimi i vetëm
që nuk mund ta rimbushni*



e shqiptarëve është një “Shqipëri e Vogël” në qendër të Londrës, ku ushqimet dhe produktet shqiptare konkurrojnë në cilësi e çmime me të gjithë produktet e tjera të Botës. Pra, produkte ‘Made in Albania’ janë prej vitësh tek “Hilal Food Centre” në Kilburn High Road. Për shqiptarët e Londrës, dhe të Britanisë së Madhe, disa vjet më parë, do të ishte një Ëndërr Britanike, por për britanikët duket se

Britanik. Krahas kësaj duhet shtuar se vetë Produktet Cilësore Shqiptare Risin Reputacionin e Shqipërisë në Britani të Madhe, pasi tek ky supermarket nuk janë vetëm shqiptarët që kërkojnë produkte cilësore shqiptare, por dhe etnitetet e tjera, ashtu sikurse ndodh që vetë shqiptarët në jo pak raste shijojnë dhe kërkojnë të provojnë produkte të shteteve



 **SUPERMARKETI
I SHQIPTARËVE**

HILAL FOOD CENTRE

Supermarketi me produktet,
çmimet, vlerat, cilësinë e
ushqimeve, produkteve, mishit,
vezëve. Konkurren kudo!



Supermarket
PAZAR E RE 2024



Kontakto
02073721059



Email
INFO@HILALFOOD.CO.UK

MIRË SE VINI

